REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
Njësia Org. / Org. Jedinice / Org. Unit: M-01
Nr. Prot: / Broj Prot: / Prot. No.: 1798/12
Nr i faqeve / Br. Stranica / No. Pages: UA-11
Data: / Datum: / Date: 03/07/2012
Prishtinë / a

Republika e Kosoves

Republika Kosova-Republic of Kosovo

*Qeveria-Vlada-Government*

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor*
*Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja*
*Ministry of Environment and Spatial Planning*

Zyra e Ministrit | Office of the Minister | Kancelarja Ministra

---

**UDHËZIMI ADMINISTRATIV Nr. 11 /2012 PËR RËNDITJEN E ELEMENTEVE TË ADRESAVE DHE CAKTIMIN E FORMATIT TË SHKRONJAVE, NUMRAVE DHE TË TABELAVE TË ADRESAVE**

**ADMINISTRATIVE INSTRUCTION No. 11 /2012 ON THE SEQUENCE OF ADDRESS ELEMENTS AND ASSIGNING THE FORMAT OF LETTERS, NUMBERS AND ADDRESS SIGNS (TECHNICAL SPECIFICATIONS)**

**ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO Br. 11 /2012 ZA POREDJIVANJE ELEMENATA ADRESA I ODREĐIVANJE FORMATA SLOVA, BROJEVA I TABELA ZA ADRESU**

| | | |
|---|---|---|
| Në Mbështetje të nenit 27, paragrafi 1. nënparagrafi 1.1. të Ligjit nr.04/L-071 për Sistemin e Adresave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 29, 27 dhjetor 2011) dhe nenit 8, paragrafi 1. nënparagrafi 1.4. të Rregullores Nr.02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, ndryshuar dhe plotësuar mr Rregulloren 07/2011, Ministri i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, nxjerr | According to article 27, paragraph 1. sub-paragraph 1.1 of the Law no.04/L-071 on Address System (Official Gazette of the Republik of Kosovo No. 29, date 27 December 2011) and article 8, paragraph 1. subparagraph 1.4. of Regulation No.02/2011 for the Field of Administrative Responsibility of the Office of the Prime Minister and Ministries, amended and supplemented by Regulation No. 07/2011 Minister of the Ministry of Environment and Spatial Planning, issues: | Na osnovu člana 27. stav 1. podstav 1.1, Zakona br. 04/L-071 o Sistemu adresa, (Službeni List Republike Kosovo Br.29, dana 27. decembra 2011), ), i člana 8 stav 1. podstav 1.4. Pravilnika Br.02/2011 o Oblastima Administrativne Odgovornosti Kancelarije Premijera i Ministarstava, izmenjenog i dopunjenog Pravilnikom br.07/2011, Ministar Ministarstva Sredine i Prostornog Planiranja, donosi |
| **UDHËZIM ADMINISTRATIV PËR RËNDITJEN E ELEMENTEVE TË ADRESAVE DHE CAKTIMIN E FORMATIT TË SHKRONJAVE, NUMRAVE DHE TË TABELAVE TË ADRESAVE** | **ADMINISTRATIVE INSTRUCTION ON THE SEQUENCE OF ADDRESS ELEMENTS AND ASSIGNING THE FORMAT OF LETTERS, NUMBERS AND ADDRESS SIGNS** | **ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO O REDOSLEDU ELEMENATA ADRESA I ODREĐIVANJU FORMATA SLOVA, BROJEVA I TABLICA ADRESA** |
| **KREU I**<br>**DISPOZITAT E PËRGJITHSHME** | **CHAPTER I**<br>**GENERAL PROVISIONS** | **POGLAVLJE I**<br>**OPŠTE ODREDBE** |
| **Neni 1**<br>**Qëllimi** | **Article 1**<br>**Purpose** | **Član 1**<br>**Svrha** |
| Qëllimi i këtij Udhëzimi administrativ është vendosja e një formati unik në territorin e Kosovës dhe përdorimi i këtij | Purpose of this Administrative instruction is to set up a unique format in the territory of Kosovo and the use of this format in the | Cilj ovog Administrativnog uputstva je postavljanje jedinstvenog formata na teritoriji Kosova i upotreba ovog formata za |

| | | |
|---|---|---|
| formati për regjistrimin e adresave dhe shkrimin korrekt të adresës; zbatimi i drejtë i këtyre parimeve do të rrisë ndjeshëm cilësinë e shërbimeve publike për një kohë më të shkurtër. | address registration and proper address writing; the proper implementation of these principles will significantly increase the quality of public services within a shorter period of time. | registrovanje adresa i pravilno pisanje adresa; pravilno sprovođenje ovih principa će povećati kvalitet javnih usluga u kraćem vremenskom periodu. |
| **Neni 2**<br>**Fushëveprimi** | **Article 2**<br>**Scope** | **Član 2**<br>**Oblast delovanja** |
| Formati i adresës në territorin e Kosovës është përcaktuar në përputhje me traditën dhe ndarjen (rregullimin) e brendshme administrative; është i përbërë nga një grup elementesh informative që përshkruajnë vendndodhjen e një ndërtese, strukture apo një parcele duke përdorur si reference zonën e qarkullimit publik dhe zonat administrative. Konkretisht, ka një renditje të elementeve të adresës duke filluar me një informacion specifik për zonën e qarkullimit publik, hyrjen në ndërtesë deri në njësinë më të vogël (apartament apo zyre) dhe përfunduar me njësinë më të madhe gjeografike që është komuna. | Address format in the territory of Kosovo is defined in compliance to good tradition and internal administrative division (regulation); it consists of a group of information elements that describe the location of a building, structure or a parcel by using as a reference the public circulation area and administrative area. Concretly, it has an order of address elements starting with specific information for the public circulation area, building entrance up to the smallest unit (apartament or office) and finalized with the largest geographic unit which is municipality; | Format adrese na teritoriji Kosova je utvrđen u skladu sa tradicijom i unutrašnjom administrativnom podelom; sastoji se od jedne grupe informativnih elemenata koje opisuju lokaciju jedne zgrade, strukture ili parcele koristeći kao referencu zonu javnog saobraćaja i administrativne zone. Konkretno, postoji redosled adresnih elemenata, počevši od specifičnih informacija za zonu javnog saobraćaja, ulaske u zgrade do najmanje jedinice (stana ili kancelarije) i završen sa najvećom geografskom jedinicom koja je opština. |
| **Neni 3**<br>**Përkufizimet** | **Article 3**<br>**Definitions** | **Član 3**<br>**Definicije** |
| 1. Shprehjet e përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë këtë kuptim: | **1.** Expressions used in this Administrative Instruction have the following meaning: | **1.** Upotrebljeni izrazi u ovom Administrativnom uputstvu imaju ovu smisao: |

| | | |
|---|---|---|
| 1.1. **Emri dhe mbiemri i personit / institucionit / organizatës / biznesit**; ky informacion shkruhet zakonisht në rreshtin e parë të adresës dhe jep informacion shtesë për identifikimin e ndërtesës. p.sh. Universiteti i Prishtinës, Ministria e Bujqësisë, Biblioteka Kombëtare, Hotel Ora; Ky informacion është fakultativ që një individ/institucion dëshiron të përfshijë në adresën e tij; | 1.1. **Name and surname of a person/ institution / organization / business;** this information is usually written in the first row of address and gives an additional information for identifying a building, i.e. University of Prishtina, Ministry of Agriculture, National Library, Hotel Ora; This information is optional for an individual/institution if he/she wants to include in his/her address. | 1.1. **Ime i prezime osobe / institucije / organizacije / biznisa;** ova informacija se obično piše na prvom redu adrese i daje dodatnu informaciju za identifikovanje zgrade, na primer: Prištinski Univerzitet, Ministarstvo Poljoprivrede, Nacionalna Biblioteka, Hotel Ora; Ova informacija je fakultativna, koju jedna osoba/ institucija želi uključiti (obuhvatiti) u svoju adresu. |
| 1.2 **Emri i zonës së qarkullimit publik** - është emri zyrtar i aprovuar nga Kuvendi i Komunës ku ka hyrje ndërtesa; ky emër identifikon emrin e zonës e qarkullimit publik dhe llojin (rrugë, bulevard, autostradë, park ose shesh) brenda një vendbanimi të caktuar dhe shërben për identifikimin e një hyrje në ndërtese përgjatë saj; | 1.2. **Name of public circulation area** - is an official name approved by the Municipal Assembly where the building's main entrance is situated; this name identifies the name of public circulation area and type (street, boulevard, highway, park or square) within a certain settlement and serves to identify a building entrance along a PCA; | 1.2. **Naziv zone javnog saobraćaja** - je zvanični naziv usvojen od Skupštine Opštine gde se nalazi glavni ulaz zgrade; ovaj naziv identifikuje ime zone javnog saobraćaja i vrstu (ulica, bulevar, autoput, park ili trg) unutar određenog naselja i služi za identifikaciju jednog ulaza u zgradi duž nje; |
| 1.3. **Numri i adresës** - është adresa zyrtare e dhëne nga komuna një ndërtese ose një hyrje të ndërtesës kur ndërtesa ka disa hyrje; pothuajse është e pranishme çdo herë në adresë dhe ndihmon për identifikimin e çdo objekti të adresuar; | 1.3. **Address number** - is an official address that is given by the municipality to a building or building entrance when the building has several entrances; it is almost always present in the address and helps to identify each addressable object; | 1.3. **Broj adrese** - je zvanična adresa koja je data od opštine jednoj zgradi ili jednom ulazu zgrade kada zgrada ima nekoliko ulaza; skoro je uvek prisutan u adresi i pomaže identifikaciji svakog adresiranog objekta. |

| | | |
|---|---|---|
| 1.4. **Numri i banesës/zyrës** - do të jenë të pranishme në ato raste kur në ndërtesë ka më shumë se një banesë /zyre/njësi. Çdo banesë apo zyre brenda një ndërtese do t'i përcaktohet një numër i cili lidhet me numrin e adresës së hyrjes përkatëse.<br>Ky informacion shërben për identifikimin e çdo banese/njësie brenda ndërtesës; në rastet kur mungon ndonjë nga elementet më sipër në regjistrin e adresave apo edhe në adresën postare të shkruar nënkupton se ndërtesa ka përkatësisht një hyrje/njësi dhe hyrja ka vetëm një banesë. Në këtë rast do të shkruhet vetëm numri i adresës; | 1.4. **Number of appartment/office,** - will be present in such cases where a building has more than one apartment/office/unit. To each apartament or office of the building will be assigned a number which will be connected with address number of relevant entrance.<br>This information serves to identify each apartament/unit within a building; in cases when one of the above elements is lacking in the address register or postal address it means that the building has one entrance and the entrance has only one apartment/unit. In this case only the address number will be written; | 1.4. **Broj stana/ kancelarije** - biće prisutan u tim slučajevima kada zgrada ima više nego jedan stan / kancelariju / jedinicu. Svakom stanu ili kancelariji u zgradi biće dodeljen broj koji će biti povezan sa adresnim brojem odgovarajućih ulaza.Ova informacija služi da identifikuje svaki stan/jedinicu unutar zgrade; u slučajeve kada jedan od gore navedenih elemenata nedostaje u adresnom registru ili poštanskoj adresi,znači da zgrada ima jedan ulaz i ulaz ima samo jedan stan/jedinicu. U ovom slučaju biće oznacen samo adresni broj. |
| 1.5. **Emri i vendbanimit** - mund të jetë vendbanimi ose fshati në të cilën ndodhet ndërtesa; | 1.5. **Name of settlement** - it can be a settlement or a village in which the building is located; | 1.5. **Naziv prebivališta** - moze biti naselje ili selo gde se nalazi zgrada. |
| 1.6. **Emri i Komunës** - në territorin ku ndodhet vendbanimi ose ndërtesa; | 1.6. **Name of Municipality** –within which is the settlement or the building; | 1.6. **Naziv Opštine** - na mestu gde je locirana zgrada. |
| 1.7. **Kodi postar** –i cili është i përbëre nga pesë shifra (karaktere numerike). Formati i tij përcaktohet nga Postë Telekomi Kosovës (PTK) dhe është element i nevojshëm në | 1.7. **Postal code** - consists of 5 digits (numeric characters). Its format is defined by the Post and Telecom of Kosovo (PTK) and it is a necessary address element for fast processing and delivery of mail. | 1.7. **Poštanski kod**- sastoji se od 5 cifara (numeričkih znakova). Njegov format je definisan od strane Pošte Telekoma Kosova (PTK) i neophodan je adresni elemenat za brzu obradu i isporuku pošte. |

| | | |
|---|---|---|
| adresë për përpunimin dhe shpërndarjen e shpejtë të postes. | | |
| **Neni 4**<br>**Parimet e Përgjithshme** | **Article 4**<br>**General Principles** | **Član 4**<br>**Opšta načela** |
| 1. Parimet e përgjithshme për mënyrën e regjistrimit të adresës në regjistër dhe mënyrën përkatëse të shkruarit të saj janë: | 1. General principles relating to the way of registration of address in the register and the way of proper writing are: | 1. Opšti principi za način registracije adrese u registar i način pravilnog pisanja su: |
| 1.1. Elementet e Adresës duhet të shkruhen të sakta, të plota dhe me shkronja të mëdha të shtypit në regjistër të adresave dhe në zarf; bëhet përjashtim për shkrimin e emrit të marrësit apo dërguesit, informacionit shtesë fakultativ në lidhje me emrin e ndërtesës apo institucionit sipas preferencës; | 1.1. The address elements should be written accurately, completely and with capital letters in the address register and envelope; with exception when writing a name of a receiver or sender, additional optional information of the building or institution according to preferences; | 1.1. Elementi adrese bih trebalo da se tačno pišu, kompletno i sa velikim slovima u adresnom registru i u koverti; sa izuzetkom kada se piše ime primaoca ili pošiljaoca, dodatne opcione informacione zgrada ili institucije u skladu sa preferencama; |
| 1.2. Shenjat e pikësimit nuk duhet të përdoren, vetëm në rastet kur janë pjesë të emrit; nuk vendosen pika në fund të fjalës, apo presje midis fjalëve; | 1.2. Punctuation marks should not be used, except when they are part of a name; no full stops are used at the end of the word, or comma between words; | 1.2. Znakovi interpunckije ne treba da se koriste,osim kada su one deo imena;tačke se ne koriste na kraju reči, ili zarez izmedju reči; |
| 1.3. Simboli # dhe shkurtime fjalësh për emrin e zonës së qarkullimit publik, vendbanimit, dhe Komunës duhet të shmangen; | 1.3. Symbol # and abbreviations for public circulation area, settlement and municipality should be avoided; | 1.3. Simbol # i skraćenice za zonu javnog saobraćaja,prebivaliste i opština treba se izbeči; |
| 1.4 Thekset mund të përdoren kur | 1.4. Accents can be used when they are an integral part of a language; | 1.4. Naglasak se koristi kada su integralni deo jezika. |

| | | |
|---|---|---|
| ato janë një pjesë integrale e gjuhës; | | |
| 1.5. Kodi postar duhet të shkruhet qartë dhe pa hapësira boshe midis numrave; | 1.5. Postal code should be clearly written and without gaps between numbers; | 1.5. Poštanski kod treba da se jasno piše, i bez prostora između brojeva; |
| 1.6. Emri i komunitetit (lagjes), fshatit, dhe Komunës sipas ligjit Për Përdorimin e Gjuhëve Nr. 02/L-37 të shkruhen në të njëjtin rresht; | 1.6. Name of community (neighbourhood), village and municipality according to the Law on the Use of Languages No.02/L-37 should be written in the same line; | 1 .6. Naziv zajednice (susedstvo), selo i opštine treba da se napišu u jednom redu u skladu sa Zakonom o Upotrebi Jezika Br. 02/L-37; |
| 1.7. Çdo rresht në adresë nuk duhet të përmbajë më shumë se sa 40 germa përfshirë këtu edhe hapësirat zbrazta; | 1.7. Each line of address should not have more than 40 letters including the spaces; | 1.7. Svaki red u adresi ne treba da sadrži više od 40 slova uključujuci i razmak; |
| 1.8 Fjalët ose numrat/shifrat nuk duhet të nënvizohen (me vizë poshtë). | 1.8. Words or numbers/ figures should not be underlined. | 1.8. Reči ili brojevi/cifre ne treba da se podvlače. |
| **KREU II<br>SPECIFIKIMET TEKNIKE TË TABELAVE TËADRESAVE** | **CHAPTER II<br>TECHINCAL SPECIFICATOINS FOR ADDRESS SIGNS** | **POGLAVLJE II<br>TEHNIČKE SPECIFIKACIJE TABELA ADRESA** |
| **Neni 5<br>Përmbajtja** | **Article 5<br>Scope** | **Član 5<br>Sadržaj** |
| Kjo pjesë e Udhëzimit ka si qëllim të përcaktojë formën, përmasat, materialin, shkrimin në tabelat për emërtime të zonave të qarkullimi publik (bulevard, shesh, park, | This part of Instruction aims to define form, size, material, font in the signs for naming public circulation areas (boulevards, squares, parks, streets, alleys, roundabouts) | Ovaj deo Uputstva ima za cilj da odredi formu, veličinu, materijal, slova u znakovima za imenovanje zone javnog saobraćaj (bulevara, trgova, parkova, ulica, |

| | | |
|---|---|---|
| rrugë, rrethrrotullim) dhe në tabelat për numrin e adresës dhe banesës.<br><br>**Neni 6**<br>**Përgjegjësitë**<br><br>1. Për zbatimin e këtij udhëzimi kompetente janë:<br><br>1.1. Agjencia Kadastrale e Kosovës e cila është në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimt Hapësinor;<br><br>1.2. Njësia për planifikim Urban në kuadër të Komunave.<br><br>**Neni 7**<br>**Tabelat e emërtimeve të zonave të qarkullimit publik**<br><br>1. Materiali i tabelës për emërtimin e ZQP-ve është fletë "3M scotchlite", prej materiali ngjitës prapareflektiv dhe me intensitet të lartë. Të gjitha tabelat e emërtimeve do të vihen jashtë në natyrë ose në ndërtesë kështu që ato duhet të jenë të qëndrueshme ndaj motit me garanci jo më pak se 10 vjet;<br><br>2. Tabela për emërtime të ZQP-ve ka formë drejtkëndore dhe përmasat e saj janë: | and signs for address and apartment number.<br><br>**Article 6**<br>**Responsibilities**<br><br>1. The responsible bodies for implementation of this instruction are:<br><br>1.1. Kosovo Cadastral Agency which is under the Ministry of Environment and Spatial Planning<br><br>1.2 Urban Planning Unit within municipalities<br><br>**Article 7**<br>**Signs of naming public circulation areas**<br><br>1. Material of the sign for naming PCA is "3M scotchlite" sheet made of adhesive retro-reflective material of high intensity. All street name signs will be displayed outdoors so they should be weather resistant with a warranty period not less than 10 years.<br><br>2. The sign with PCA name has rectangular form and the size is as follows: | kružnih puteva) i na tabelama za broj adrese i stana.<br><br>**Član 6**<br>**Odgovornosti**<br><br>1. Za sprovođenje ovog uputstva nadležni su:<br><br>1.1 Kosovska Katastarska Agencija, koja je u sklopu Ministarstva sredine i prostornog planiranja;<br><br>1.2 Jedinica za Urbano planiranje koja je unutar opštine.<br><br>**Član 7**<br>**Tablice imenovanja zona javnog prometa**<br><br>1. Materijal tabele za imenovanje ZJP-a je„3M scotchlite" list, od lepljivog retro reflektujućeg materijala visokog intensiteta. Svi ulični nazivi će biti prikazani na otvorenom prostoru samim tim one moraju da budu dobrog kvaliteta,vremenski otporne i postojane. Period garancije ne manja od 10 godina.<br><br>2. Znakovi za imena ZJP-a ima pravougaonu formu i njena veličina sledeča: |

| | | |
|---|---|---|
| 2.1. Gjatësia e nevojshme (nga 60 cm deri në 100 cm) x gjerësi 25 cm.<br>Minimumi i gjatësisë së tabelës është 60 cm dhe maksimumi i saj mund të arrijë deri në 100 cm (Fig.1-a) (Shih kriteret e emërtimit në lidhje me gjatësinë e emrit tek Udhëzimi 27.2).;<br><br>2.2. Përmasat e parashikuara të tabelave mundësojnë lexueshmërinë e qartë në distancë dhe në lëvizje nga të gjitha këndvështrimet në udhëkryqe. Gjatësia e tabelës deri në 100 cm mundëson leximin e qartë edhe të emrave të gjatë. Në ketë mënyrë sigurohet që edhe emrat e gjatë janë njësoj të lexueshme ashtu si emrat e shkurtër duke mbajtur madhësinë e shkrimit të pandryshueshme. | 2.1. Necessary length (from 60 cm to 100 cm) x width 25 cm.<br>Minimum length of the sign is 60 cm and its maximum can reach up to 100 cm (Fig.1-a) (see the naming criteria relating to the length of name in Instruction 27.2).<br><br>2.2. The provided sign sizes allow clear readability in a distance and movements at all angles and intersections. Length of the sign up to 100 cm allows clear legibility including long names. In this way is ensured that the long names are equally readable as the short names by keeping the same font size. | 2.1. Potrebna dužina (od 60 cm do 100 cm) x širina 25 cm.<br>Minimum dužina znaka je 60 cm a njegov maksimum može dostići do 199 cm (Fig.1-a) (vidi kriterijume imenovanja u vezi sa dužinom imena u Uputstvo 27.2).<br><br>2.2. Predviđena veličina znaka omogućava jasnu čitljivost sa daljine u pokretu u svim uglovima i raskrsnicama. Dužina znaka do 100 cm, omogućava jasnu čitljivost uključujuci i duga imena. Na ovaj način se osigurava da duga imena su podjednako čitljiva kao i kratka imena drzeči nepromenljivu veličinu slova. |
| 3. Mbishkrimi përbehet nga shkronja të mëdha shtypi me ngjyrë të bardhë, mbi sfond me ngjyrë blu dhe korniza e tabelës është ngjyrë të bardhë.<br><br>**Neni 8**<br>**Lloji dhe madhësia e shkrimit**<br><br>1. Lloji i shkrimit në tabelën për emërtime është "Calibri". Shkronjat janë të printuara me një reliev me lartësi 1mm; emri | 3. Inscription consists of white capital letters on blue background and sign border of white colour.<br><br>**Article 8**<br>**Font and size of writing**<br><br>1. Type of font of the street name sign is "Calibri". Letters are printed with a relief of 1mm; name is written on both sides of | 3. Natpis se sastoji od belih velikih slova sa belom bojom na plavoj pozadini i okvir znaka je bele boje.<br><br>**Član 8**<br>**Vrsta i veličina pisanja**<br><br>1. Vrsta fonta (slova) uličnih znakova je ''Calibri''.Slova su štampana sa reljefom od 1mm; naziv je pisan na obe strane |

| | | |
|---|---|---|
| shkruhet në të dyja anët e tabelës; | the sign; | znaka; |
| 1.1. Lloji i ZQP-së shkruhet me shkurtesë në rreshtin e parë në të dy gjuhët zyrtare: RR. / UL.; | 1.1. Type of PCA is written in the first line with abbreviation in two official languages: RR. / UL.; | 1.1. Vrsta ZJP-a je pisan u prvoj liniji sa skračenicom u dva zvanična jezika: RR./UL.; |
| 1.2. Emri zyrtar i miratuar nga Kuvendi i Komunës shkruhet i plotë dhe i saktë siç është shkruar në vendimin e emërtimit në rreshtin e dytë: ISA BOLETINI; | 1.2. The official name approved by Municipal Assembly is written accurately and completely as it is decided in the naming decree, in the second line: ISA BOLETINI; | 1.2. Zvanični naziv usvojen od Skupštine Opštine se piše tačno i potpuno kao sto je odlučeno u uredbi o imenovanju u drugom redu: ISA BOLETINI; |
| 1.3. Në komunat ku përdoret edhe një gjuhë e tretë zyrtare (p.sh Turqisht) – lloji i ZQP-së shkruhet i shkurtuar në të tre gjuhët të ndara midis tyre me vizë të pjerrët (Fig1-b): RR./UL./SK; | 1.3. In municipalities where a third official language is used (i.e. Turkish) –type of PCA written in the sign is abbreviated and divided with slash in all three languages (Fig.1-b): RR./UL./SK; | 1.3. U opštinama gde je u upotrebi treći službeni jezik (n.p. Turski) -tip OJC-a pisan na znaku je skraċen i podeljen kosom crtom u sva tri jezika (Fig.1-b):RR./UL./SK; |
| 1.4. Në tabelat për emërtime të rrugëve lartësia e shkronjës është 7 cm. Emri dhe lloji i ZQP-së pozicionohet në mes të tabelës dhe brenda kornizës së bardhë; | 1.4. In the street name signs the height of the letter is 7 cm. Name and type of PCA is positioned in the middle of the sign and within the white border; | 1.4. Na znakovima puta visina slova je 7 cm. Ime i vrsta ZJP-a je pozicionirana u sredini znaka i unutar belog okvira; |
| 1.5. Hapësira midis tekstit dhe kornizës së bardhë në pjesën e sipërme dhe të poshtme të tabelës është e njëjtë. | 1.5. The space between the text and the white border in the upper part and lower part of the sign is the same. | 1.5. Prostor između teksta i belog okvira na gornjem delu i donjem delu znaka su iste. |
| **Neni 9**<br>**Tabelat e numërtimeve** | **Article 9**<br>**Numbering signs** | **Član 9**<br>**Numerisanje znakova** |

| | | |
|---|---|---|
| 1. Tabelat e numërtimeve ndahen në dy kategori:<br><br>1.1. Kategoria A - Tabela për numrin e adresës së ndërtesave;<br><br>1.2. Kategoria B - Tabela për numrin e banesës/zyrës/ (njësive të brendshme) që aksesohen nëpërmjet hyrjes në ndërtese.<br><br>2. Materiali për kategorinë A është fletë alumini i veshur me një material prapareflektiv të klasit të I.<br><br>3. Materiali për kategorinë B mund të jetë material alumini, plastik, ose bronzi në varësi të preferencave të qytetarit. Rekomandohet përdorimi i të njëjtit material për tabelat të kategorisë B për gjithë banesat /zyrat brenda një ndërtese kolektive banimi ose biznesi, ose ndërtese shumë funksionale etj.<br><br>**Neni 10**<br>**Ngjyra e tabelave të numrave**<br><br>1. Tabela e kategorisë A: numrat shkruhen me ngjyrë e bardhe mbi sfond me ngjyrë blu. Korniza e tabelës është me ngjyrë të bardhë. | 1. Signs of numbering are divided into two categories:<br><br>1.1. Category A - Sign of building address number;<br><br>1.2. Category B - Sign of apartment/office (internal units) number accessed through the building entrance.<br><br>2. Material for A category is made of aluminium sheet coated with retro-reflective material of class I.<br><br>3. Material for B category might be of aluminium, plastic or bronze depending on individual preferences. It is recommended to use the same material for the signs of B category for all apartments/offices located within one apartment or business building, or multi functional facility etc.<br><br>**Article 10**<br>**Colour of numbering signs**<br><br>1. Sign of category A: numbers are written with white colour on the blue background. The border of the sign is of white colour. | 1. Znakovi numerisanja su podeljeni u dve kategorije:<br><br>1.1. Kategorija A - Znak adresnog broja;<br><br>1.2. Kategorija B - Znak stana / kancelarije (unutrašnje jedinice) pristupačne kroz ulaz zgrade.<br><br>2. Materijal za A kategoriju je od aluminijumskog lima obložen sa retro reflektujući materijal I klase.<br><br>3. Materijal za B kategorjiju može biti od aluminijuma, plastike ili bronze, u zavisnosti od preferincije građana. Preporučena je upotreba istog materijala za znakove B kategorije za sve stanove/ kancelarije locirane unutar jedne kolektivne zgrade stanovanja ili biznisa, ili više-funkcionalnog objekta, itd.<br><br>**Član 10**<br>**Boja tabela brojeva**<br><br>1. Znakovi A kategorije: brojevi su pisani belom bojom na plavoj pozadini. Okvir znakova je bele boje. |

| | | |
|---|---|---|
| 2. Tabela e kategorisë B: numrat shkruhen me ngjyrë të zezë, mbi sfond me ngjyrë të bardhë.<br><br>**Neni 11**<br>**Forma dhe madhësia e tabelave të numrave**<br><br>1. Tabela e numrave ka formë drejtkëndorë. Madhësia e tabelës së kategorisë A për numrin e adresës është: gjatësia e nevojshëm x gjerësi 15 cm (Fig. 2-a). | 2. Sign of category B: numbers are written with black colour on the white background.<br><br>**Article 11**<br>**Form and size of the numbering signs**<br><br>1. Sign of numbers has a rectangular form. The size of sign of category A for the address number is: necessary length x width 15 cm (Fig.2-a). | 2. Znakovi B kategorije: brojevi su pisani crnom bojom na beloj pozadini.<br><br>**Član 11**<br>**Oblik i veličina tabela brojeva**<br><br>1. Znakovi broja imaju pravougaonu formu.Veličina znaka A kategorije za adresni broj je:potrebna dužina x širina 15 cm(Fig.2-a). |
| 2. Gjerësia e tabelës (15 cm) është e njëjtë për të gjitha tabelat e Kategorisë A pavarësisht nga numri i shifrave (një, dy, tre, katër, pesë). | 2. Width of the sign (15 cm) is the same for all signs of category A regardless of the number of digits (one, two, three, four, five). | 2. Širina znaka (15 cm) je ista za sve znakove kategorije A nezavisno od broja cifara(jedan,dva,tri,četiri,pet). |
| 3. Tabelat me një shifër dhe dy shifra kanë gjatësi të njëjtë. | 3. Signs with one and two digits have the same length. | 3. Znakovi sa jednim ili više cifara imaju istu dužinu. |
| 4. Tabela me më shumë se dy shifra do të ketë gjatësinë e nevojshme për të akomoduar 3, 4 apo 5 shifra duke marre në konsideratë edhe rastet kur kemi numër adrese me fraksion p.sh. 271/3. | 4. The sign with more than two digits will have the necessary space to accommodate 3, 4, or 5 digits taking into account cases when we have the address number with fraction e.g. 271/3. | 4. Znak sa više od dva cifara imaće neophodni razmak za primanje 3,4 ili 5 cifara uzimajući u obzir slučajeve kada imamo adresne brojeve sa frakcijom n.p. 271/3. |
| 5. Madhësia e tabelës së kategorisë B për numrin e banesës/zyrë është: gjatësia e nevojshme x gjerësi 5 cm (Fig.2-b). | 5. The size of the sign of B category for the apartment/office/unit number is: the necessary length x width 5 cm (Fig.2-b). | 5. Veličina znaka B kategorije za broj apartmana/kancelarije/jedinice je:potrebna dužina x širina 5 cm ( Fig.2;b). |

| | | |
|---|---|---|
| 6. Në tabelat për numërtime fonti i shkrimit është “Calibri”. | 6. In the signs of numbering the font is “Calibri”. | 6. U znacima za numerisanje font slova je ‘’ Calibri’’. |
| 7. Në tabelat për numërtime lartësia e numrit është si vijon: | 7. In the signs of numbering the height of the number is as follows: | 7. U znacima numerisanja visina broja je sledeća: |
| 7.1. Lartësia e numrit është 12 cm në tabelën e kategorisë A e cila montohet në mur në pjesën e jashtme të ndërtesës dhe në krahun e djathtë të çdo hyrje në ndërtese; | 7.1. The height of the number of the sign of category A is 12 cm, which is installed on the wall on the outer part of the building and on the right side of each building entrance; | 7.1 Visina broja na znaku A kategorije je 12 cm-instalira se na zidu na spoljnom delu zgrade i na desnoj strani svakog ulaza zgrade. |
| 7.2. Lartësia e numrit është 4 cm në tabelën e kategorisë B – (vendoset lart në kornizën e derës së çdo banese apo zyre ose në pamundësi montohet në mur në krahun e djathtë të derës. Shih Udhëzimin 27.3); | 7.2. The height of the number of the sign of category B is 4 cm – (is installed up on the center of the doorframe or if not possible is installed on wall on the right side of each apartment/office door. See Instruction 27.3); | 7.2 Visina broja na znaku B kategorije je 4 cm – (instalira se gore na centru okvira vrata ili u nemogućnosti, instalira se na zidu na desnoj strani vrata.Vidi AU 27.3) |
| 7.3. Numrat për të dy kategoritë shkruhen në mes të tabelës. Nëse numri përbehet nga një apo disa shifra dhe një shkronjë – shkronja shkruhet me gërme të madhe dhe në pozicionin djathtas lart p.sh 301 $^{A}$ ndërsa për rastet e numrit të adresës me fraksion shkruhet p.sh 57/1; | 7.3. Numbers of both categories are written in the middle of the sign. If the number consists of one or several digits and one letter – the letter is in capital and superscripted on the right e.g. 301 $^{A}$ whereas in cases of address number with fraction it is written i.e.57/1; | 7.3 Brojevi za obe kategorije su pisani u sredini znaka. Ako se broj sastoji od jednog ili više cifara - slova su velika i natpis stoji desno n.p. 301 A, dok u slučajevima adresnog broja sa frakcijom piše se na n.p. 57/1; |
| 7.4. Hapësira e numrit nga të dy anët e kornizës (sipërme dhe poshtme) së tabelës është e njëjtë. | 7.4. The space of the number is the same on both sides of the sign frame (upper and lower part). | 7.4 Razmak broja sa obe strane okvira znaka (gornji i donji deo) je isti. |

| Neni 12<br>**Hyrja në fuqi** | Article 12<br>**Entry into force** | Član 12<br>**Stupanje na snazi** |
|---|---|---|
| Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i MMPH-së. | This Administartive Instruction enters into force from the day of signing by the Minister of MESP. | Ovo Administrativno Uputstvo stupa na snagu na dan potpisivanja od strane Ministra MSPP-a. |
| Dardan Gashi | Dardan Gashi | Dardan Gashi |
| Ministri i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor | Minister of Ministry of Environment and Spatial Planning | Ministar Ministarstva Sredine i Prostornog Planiranja |
| Datë: | Date: | Datum: |
| Prishtinë | Pristina | Priština |

## Shtojca A

---

Adresa u vjen në ndihmë shtetasve dhe vizitorëve në Kosovë të lokalizojnë një ndërtesë/banesë, një rrugë, një shesh, një park, një biznes, apo një zyre shërbimi. Adresa përbëhet nga disa elemente të rëndësishme ku secili prej tyre përmban informacionin lidhur me individin, vendbanimin dhe vendin e punës në të cilin personi realisht jeton ose punon.

Më poshtë janë disa raste të adresave që mund të hasen gjerësisht në jetën e përditshme:

**Adresë e një individi në zonë urbane:**

| | |
|---|---|
| Isa Muharremi | *Emri Mbiemri i personit* |
| Rruga Fehmi Agani | *Emri dhe lloji i ZQP* |
| Nr.131 Ban.11 | *Numri i adresës + banesës* |
| Dardani Prishtinë 10000 | *Emri i vendbanimit + Komuna + Kodi Postar* |

**Adresë biznesi me kuti postare:**

| | |
|---|---|
| Arbesa Turist | *Emri i Biznesit* |
| Sheshi Adem Jashari Zyra 308 | *Emri dhe lloji i ZQP + numri i zyrës* |
| Kutia Postare 107 | *Kutia postare + numrin e kutisë* |
| Ferizaj 70000 | *Komuna + Kodi Postar* |

**Adresë për institucione/biznese pa kuti postare:**

| | |
|---|---|
| Universiteti FAMA | *Emri i Institucionit* |
| Rruga Gustav Mayer Nr.7 | Emri dhe lloji i ZQP + Numri i adresës |
| Prishtinë 10000 | *Komuna + Kodi Postar* |

**Adresë e një individi në zonë rurale:**

| | |
|---|---|
| Sulejman Kaba | *Emri Mbiemri i personit* |
| Rruga Mustafë Venhari Nr.123 | *Emri dhe lloji i ZQP + Numri i* i adresës |
| Bardh i Madh Fushë Kosovë 12000 | *Emri i vendbanimit + Komuna + Kodi Postar* |

## Shtojca B

Më poshtë jepen të ilustruara shembuj të tabelave të emrave dhe të adresës dhe nën adresës:

I. Tabelat e emrave të zonave të qarkullimit publik:




Fig.1.a




Fig.1.b

**II.** Më poshtë jepen të ilustruara disa shembuj për tabelat e numrave të adresës dhe numrave për banesë/zyrë:

a) Tabela e numrave të adresës (hyrje në ndërtesë) me një ose më shumë shifra




Fig 2.a

b) Tabela e numrave të banesës/zyrës (njësitë brenda një ndërtese) me një ose më shumë shifra




Fig.2.b

## Annex A

An address helps citizens and visitors in Kosovo to localize a building/apartment, street, square, park, business or a service office. Address consists of several important elements, where each of them contains information of an individual, settlement and working place where a person lives or works.
Further on are shown some address cases used in everyday life:

**Address of an individual in an urban area:**

| | |
|---|---|
| Isa Muharremi | Recipent Name |
| Fehmi Agani Street | *Name and type of PCA* |
| No.131 Apt.11 | Address *Number + apartment number* |
| Dardani Prishtine 10000 | *Settlement name + Municipality + Postal Code* |

**Business Address with a mailbox:**

| | |
|---|---|
| Arbesa Turist | *Name of Business* |
| Adem Jashari Square - Office 308 | *Name and type of PCA + unit number* |
| Mailbox 107 | *Mailbox + box number* |
| Ferizaj 70000 | *Municipality + Postal Code* |

**Address for institutions/ businesses without mailbox:**

| | |
|---|---|
| University FAMA | *Name of Institution* |
| Gustav Mayer Street No.7 | *Name and type of PCA +* Address *Number* |
| Prishtine 10000 | *Municipality + Postal Code* |

**Address of an individual in rural area:**

| | |
|---|---|
| Sulejman Kaba | Recipient name |
| Mustafe Venhari Street No.123 | *Name and type of PCA+* Address *Number* |
| Bardh i Madh Fushe Kosove 12000 | *Settlement Name+Municipality + Postal Code* |

## Annex B

Further on are given some illustrated examples of address and sub-address name signs:

I. Public circulation areas name signs:




Fig.1.a




Fig.1.b

II. Further on are given some illustrated examples on address number signs and apartament/office number signs:

a) Address number sign (entrance of the building) with one or more digits




Fig 2.a

b) Address number sign of apartment/office (units within a building) with one or more digits




Fig.2.b

# Aneks A

Adresa dolazi u pomoć državljanima i posetiocima na Kosovu u smislu lokalizacije objekta/stana, puta, trga, parka, biznisa, ili službene kancelarije. Adresa se sastoji od nekoliko važnih elemenata,gde svaki od njih sadrži informacije u vezi sa individom,prebivalištem i radno mesto u kome osoba realno živi ili radi.

Dole su navedeni neki slučajevi adresa koje možete opširnije sresti u svakodnevnom životu:

**Adresa jedne individe u urbanoj zoni:**

| | |
|---|---|
| Isa Muharemi | *Ime i prezime osobe* |
| Ulica Fehmi Agani | *Naziv i ime ZJS* |
| Br.131 Ban.11 | *Broj adrese+stana* |
| Dardanija Priština 10000 | *Naziv prebivališta + Opština+ Poštanski Kod* |

**Adrese biznisa sa poštanskom kutijom:**

| | |
|---|---|
| Arbesa Turist | *Naziv Biznisa* |
| Trg Adem Jašari Kancelarija 308 | *Ime i tip ZJS + broj kancelarije* |
| Poštanska kutija | *Poštanska kutija+ broj kutije* |
| Uroševac 70000 | *Opština + Poštanski Kod* |

**Adresa za institucije/biznisa bez poštanske kutije:**

| | |
|---|---|
| Univerzitet FAMA | *Naziv Institucije* |
| Ulica Gustav Mayer Nr.7 | *Naziv i tip ZJS + Broj adrese* |
| Priština 10000 | *Opština + Poštanski Kod* |

**Adresa jedne individe u ruralnim zonama:**

| | |
|---|---|
| Sulejman Kaba | *Ime i prezime osobe* |
| Ulica Mustafa Venhari Nr.123 | Naziv i tip ZJS+ *Broj adrese* |
| Veliki Barl Kosovo Polje 12000 | *Naziv prebivališta+ Opština + Poštanski Kod* |

## Aneks B

Dole su navedeni  ilustrirani primeri tabela sa nazivima, adresama i pod adresama

**I.** Tabele naziva oblasti javne cirkulacije:




Fig.1.a




Fig.1.b

**III.** Dalje navedeni su ilustrirani primeri tabela adresa i brojeva za stanove/kancelarije:

c) Tabela brojeva adresa(ulazak u zgrade) sa jednim ili više cifara




Fig 2.a

d) Tabela brojeva stana/kancelarije (jedinice unutar jedne zgrade) sa jednim ili više cifara




Fig.2.b